



REPubLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPËSTINA VUÇITRN

01 Nr. / Br 62/16

Nr. i fq. / Br. st - 9 -

Data: / Datum 31. 03. 2016

VUSHTRRI - VUÇITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS - VUSHTRRI

**RREGULLORE (KKV) NR.02/ 2016
PËR MENAXHIMIN E PARKINGJEVE PUBLIKE NË KOMUNËN E
VUSHTRRIË**

Mars 2016

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika (c) dhe nenit 17 pika (c) dhe (p) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008) nenit 41 paragrafi 2 pika (c) e Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, në mbledhjen e mbajtur me **31 mars 2016** miratoj këtë:

Rregullore
Për menaxhimin e parkingjeve publike në Komunën e Vushtrrisë

Neni 1
Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim të rregullojë mënyrën e menaxhimit dhe shfrytëzimit të rregullt dhe efikas të parkingjeve publike në Komunën e Vushtrrisë.

Neni 2
Fushëveprimi

Menaxhimin e punëve për rregullimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e parkingjeve publike e ushtron personi juridik apo fizik i cili përcaktohet nëpërmjet procedurave të zhvilluara nga Drejtoria e Prokurimit, duke respektuar kushtet dhe kriteret që i përcakton Drejtoria për Shërbime Publike.

Neni 3
Përkufizimet

I. Përkufizimet në vijim në kuptim të kësaj rregulloreje kanë këtë domethënie:

- 1.1. DSHP - Drejtoria për Shërbime Publike.
- 1.2. Parkingjet publike - janë sipërfaqet e trafikut publik dhe sipërfaqet e veçanta të caktuara dhe të shënuara për parkim të mjeteve motorike.
- 1.3. Parkingjet e përhershme - janë objektet e ndërtuara për parking, sipërfaqet e trafikut publik dhe sipërfaqet e posaçme të ndërtuara dhe të shënuara për parking.
- 1.4. Parkingjet e përkohshme - janë sipërfaqet e trafikut publik të rregulluara përkohësisht dhe sipërfaqet e posaçme të caktuara dhe të shënuara për parking.
- 1.5. Parkingjet e kohëpaskohshme - janë sipërfaqe të trafikut publik në afërsi të objekteve në të cilat zhvillohen aktivitete sportive, kulturore, artistike, panaire, me kohëzgjatjen e tyre, të cilat janë të shënuara posaçërisht për parking të mjeteve motorike.
- 1.6. Inspektor i trafikut – nënkupton inspektorin apo inspektorët që veprojnë në kuadër të Drejtorisë për Inspektime të Komunës së Vushtrrisë.

Neni 4

Parkingjet publike

1. Parkingje publike në këtë rregullore trajtohen vetëm sipërfaqet e trafikut publik dhe sipërfaqet e veçanta të caktuara dhe të shënuara për parkim të mjeteve motorike.
2. Parkingje publike në këtë rregullore nuk konsiderohen sipërfaqet për parkim të mjeteve motorike që i takojnë objektit përkatës (objektet afariste ose banesore etj.), si dhe sipërfaqet e caktuara për parkim të mjeteve motorike të veçanta.

Neni 5

Ndarja e parkingjeve publike

1. Parkingjet publike mund të jenë:
 - 1.1. Parkingjet e përhershme;
 - 1.2. Parkingjet e përkohshme;
 - 1.3. Parkingjet e kohëpaskohshme.

Neni 6

Kompensimi për shfrytëzimin e parkingjeve publike

1. Parkingjet publike në kuptimin e kompensimit për shfrytëzimin e tyre mund të jenë:
 - 1.1. Parkingjet e përgjithshme, për shfrytëzimin e të cilave nuk paguhet çmimi i parkimit (parkingjet e kohëpaskohshme) dhe
 - 1.2. Parkingjet e posaçme, për shfrytëzimin e të cilave paguhet çmimi i parkimit.

Neni 7

Destinimi i parkingjeve publike

1. Parkingjet publike, varësisht prej llojit të mjeteve motorike, mund të destinohen për parkim të:
 - 1.1. Mjeteve motorike për udhëtarë;
 - 1.2. Autobus;
 - 1.3. Mjete transportuese;
 - 1.4. Motoçikleta, triçikleta, etj;
 - 1.5. Rimorkiove.

Neni 8
Ndarja në zona e parkingjeve publike

1. Parkingjet e posaçme, sipas kohës së lejuar për parkim dhe lartësisë së çmimit të parkimit, ndahen në zona:

1.1. Zona e parë, në të cilat koha e parkimit kufizohet në 120 minuta;

1.2. Zona e dytë, vende me shkallë të lartë të shfrytëzimit, në të cilat koha e parkimit nuk është e kufizuar; dhe

1.3. Zona e tretë, vende me shkallë të ultë të shfrytëzimit, në të cilat koha e parkimit nuk është e kufizuar.

Neni 9
Mënyra e kontrollimit të parkingjeve publike

1. Në parkingjet e posaçme mund të bëhet kontrollimi i hyrje-daljeve të mjeteve motorike.

2. Kontrollimi nga paragrafi 1 i këtij neni mund të bëhet duke vendosur rampën, ndërtimin apo vendosjen e objektit për pagesë, ose në ndonjë mënyrë tjetër.

Neni 10
Caktimi i lokacioneve për parkingje publike

Parkingjet publike caktohen me vendim të Kuvendit të Komunës, me propozim të DSHP-së.

Neni 11
Sinjalizimi i parkingjeve publike

1. Parkingjet publike duhet të jenë të sinjalizuara me sinjalizim përkatës horizontal dhe vertikal, në përputhje me rregullat për siguri në trafik.

2. Parkingjet e posaçme, përveç sinjalizimit për trafik, duhet të kenë të shënuar në vend të dukshëm të dhënat si: zonën e parkimit, llojin e mjeteve motorike, çmimin e parkimit dhe kohëzgjatjen e parkimit.

Neni 12

Rregullimi, mirëmbajtja dhe shfrytëzimi i parkingjeve publike

1. Personi juridik apo fizik, të cilit përmes procedurave të tenderimit iu ka besuar puna e shfrytëzimit të parkingjeve publike, është i obliguar të rregullojë, mirëmbajë dhe të sinjalizojë parkingjet publike.
2. Mjetet financiare për kryerjen e punëve nga paragrafi 1 i këtij neni, në parkingjet e posaçme sigurohen nga të hyrat e inkasuara nga pagesa e parkingut.

Neni 13

Detyrat dhe përgjegjësitë e shfrytëzuesve të parkingjeve

1. Shfrytëzues të parkingjeve publike janë ngasësit, gjegjësisht pronarët e mjeteve motorike.
2. Shfrytëzuesit janë të obliguar të shfrytëzojnë parkingjet në përputhje me sinjalizimin e trafikut dhe shenjave të përcaktuara në nenin 11 paragrafi 2. i kësaj rregulloreje.

Neni 14

Vend-parkimet për personat me nevoja të veçanta

Vend-parkimet për persona me nevoja të veçanta, duhet të jenë të sinjalizuara dhe të njëjtat mund t'i shfrytëzojnë vetëm personat të cilët posedojnë dokumentacion, me të cilin dëshmohet se personi ka nevoja të veçanta.

Neni 15

Lloji i mjeteve motorike që lejohet të parkohen në parkingjet publike

1. Parkingjet publike të destinuara vetëm për një lloj të mjeteve motorike, mund të shfrytëzohen vetëm për atë lloj të mjeteve motorike.
2. Në parkingjet publike për mjete transportuese dhe autobus duhet të ndërtohet nyja sanitare.

Neni 16

Rezervimi i vend parkimeve për raste të veçanta

1. DSHP-ja në raste të veçanta mund të lejojë rezervimin e vend-parkimit në parkingjet publike për nevoja të organeve shtetërore apo përfaqësuesve tjerë të huaj, shërbimeve publike, ndërmarrjeve publike si „UNITETI”, „MITROVICA”, „KEDS”, si dhe transportuesit e rregullt të udhëtarëve të cilët janë të obliguar të pajisen me licencë duke përfshirë; taksit individual, radio taksit, autobusët dhe mjetet me më shumë se 8+1 ulëse.
2. Në këto vend-parkingje të rezervuara në parkingjet e veçanta, gjatë kohës së rezervimit të vend-parkimit nuk zbatohen dispozitat e nenit 8 paragrafi 1 dhe 2 për kufizimin kohor të shfrytëzimit të parkimit të posaçëm.

3. DSHP-ja përcakton me vendim të veçantë kushtet për rezervimin e vend parkimit nga paragrafi 1 i këtij neni.

Neni 17

Mënyra e pagesës së çmimit për parkim

1. Për shfrytëzimin e parkingut të posaçëm, shfrytëzuesi është i obliguar të paguaj çmimin e parkimit, varësisht nga koha e shfrytëzimit të vend parkimit dhe zonës në të cilën gjendet vend parkimi.
2. Vlera e pagesës së parkimit sipas paragrafit 1 të këtij neni dhe vlera e provizionit për komunën, përcaktohet në bazë të procedurave të tenderimit.
3. Kjo vlerë e pagesës nuk mund ta tejkalojë shumën maksimale të përcaktuar në Rregulloren Nr. 278/15 dt. 30.12.2015 për Tarifa dhe Ngarkesa Komunale.

Neni 18

Obligimet e shfrytëzuesit

1. Shfrytëzuesi është i obliguar të paguaj çmimin e parkimit nga neni 17. paragrafi 1 i kësaj rregulloreje për çdo orë të filluar të shfrytëzimit.
2. Shfrytëzuesi është i obliguar të respektojë kohën e lejuar për parkim.

Neni 19

Obligimet e personave me nevoja të veçanta

1. Shfrytëzimin e vend parkimeve të caktuara për persona me nevoja të veçanta në parkimet e posaçme, nuk e paguajnë shfrytëzuesit të cilët në automjet kanë të ekspozuar në vend të dukshëm tiketën ngjitëse, gjegjësisht shenjën përkatëse të personit me nevoja të veçanta.
2. Nuk paguhet çmimi i parkimit gjatë kohës së aksioneve intervenuese për: automjetet e ndihmës së parë, policisë, Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Njësisë së Zjarrfikësve.

Neni 20

Shfrytëzimi i parkingjeve nga subjektet tjerë

Subjektet tjera siç janë: banorët, shfrytëzuesit e lokaleve afariste, etj. mund të shfrytëzojnë parkingjet në bazë të një marrëveshje me operatorin që menaxhon parkingjet publike, në harmoni me kushtet dhe mënyrën që e përcakton DSHP-ja, konform Rregullores Nr. 278/15 dt. 30.12.2015 për Tarifa dhe Ngarkesa Komunale.

Neni 21

Shfrytëzimi i parkingjeve të përgjithshme

1. Për parkingjet e përgjithshme, për shfrytëzimin e të cilave nuk paguhet çmimi i parkimit (parkingjet e kohëpaskohshme), sipas nenit 6 paragrafi 1 alineja 1 e kësaj rregulloreje, komuna apo operatori ekonomik i përzgjedhur, nuk mban përgjegjësi për dëmtime apo vjedhje të automjetit apo të gjërave brenda automjetit në parkingje publike.
2. Në parkingjet publike, të cilat iu kanë besuar punët e rregullimit, mirëmbajtjes dhe shfrytëzimit, personave juridik apo fizik, sipas nenit 12 të kësaj rregulloreje, shfrytëzuesi i parkingut duhet të përkujdeset për mos dëmtimin apo mos vjedhjen e mjeteve motorike.

Neni 22

Kontrolli i shfrytëzimit të parkingjeve publike

1. Kontrollin e pagesës dhe shfrytëzimit të parkingjeve të posaçme e bëjnë personat e autorizuar nga menaxheri.
2. Personat e autorizuar duhet të posedojë kartë identiteti dhe janë të obliguar të bartin uniformën.
3. Menaxheri përcakton dukjen dhe përmbajtjen e kartelës së identitetit të personave të autorizuar, si dhe dukjen e uniformes nga paragrafi 2 i këtij neni.

Neni 23

Shfrytëzimi jo i duhur i parkingjeve

1. Shfrytëzuesi i cili shfrytëzon parkingun e posaçëm në kundërshtim me nenin 18 të kësaj rregulloreje, është i obliguar të paguaj çmimin e posaçëm të parkimit, sipas çmimoreve së përcaktuar nga menaxheri.
2. Urdhëresën për pagesën e çmimit të posaçëm e lëshon personi i autorizuar dhe ia dorëzon pronarit të mjetit motorik.
3. Kur personi i autorizuar nuk ka mundësi që ta dorëzojë urdhër-pagesën, të njëjtën e vendos në mjet motorik.
4. Dorëzimi i urdhërpagesës në mënyrën e përshkruar në paragrafin 3 të këtij neni, konsiderohet i rregullt dhe dëmtimi ose asgjësimi i mëvonshëm i urdhër-pagesës nuk ka ndikim në vlefshmërinë e dorëzimit dhe nuk e shtynë afatin e pagesës.
5. Shfrytëzuesi është i obliguar që në afat prej tetë (8) ditësh, të bëjë pagesën në mënyrën e përshkruar në urdhërpagesë.

Neni 24

Ndalesat

1. Ndalohet parkimi i mjeteve motorike në kundërshtim me sinjalizimin e trafikut sipas nenit 13 paragrafi 2 i kësaj rregulloreje, si dhe çfarëdo pagese për shfrytëzimin e tillë të parkingjeve publike.
2. Ndalohet parkimi i mjeteve motorike të paregjistruara apo pa tabela të regjistrimit.
3. Ndalohet parkimi i mjeteve motorike në vend parkim të rezervuar për parkim të automjeteve për persona me nevoja të veçanta, nëse nuk kanë tiketën ngjithëse sipas nenit 13 paragrafi 2 të kësaj rregulloreje.
4. Ndalohet parkimi i mjeteve motorike të dëmtuara, parkimi i rimorkiove pa mjetin tërheqës, përdorimi i parkingut në kundërshtim me destinimin, rrethimi i vend-parkimit, rregullimi i vend-parkimit të rezervuar me vetë dëshirë, larja e automjeteve, vendosja e shitësve ambulant, dhe aktivitete tjera që sjellin papastërti dhe dëmtim të parkingut publik.

Neni 25 Mbikëqyrja

1. Mbikëqyrjen e zbatimit të kësaj rregulloreje e bënë DSHP-ja dhe Drejtoria për Inspektime.
2. Punët në mbikëqyrjen inspektuese në zbatimin e kësaj rregulloreje dhe akteve të tjera të nxjerra në bazë të kësaj rregulloreje i kryen Drejtoria për Inspektime nëpërmjet Inspektorit të trafikut.

Neni 26 Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë për Inspektime në fushën e parkingjeve publike

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë për Inspektime në fushën e parkingjeve publike janë:
 - 1.1. Të kontrollojë sinjalizimin e trafikut në parkingjet publike dhe t'i urdhërojë menaxherit për të mënjanuar mangësitë eventuale në afat të caktuar;
 - 1.2. Të kontrollojë gjendjen teknike të parkingjeve publike dhe të urdhërojë menaxherin për të mënjanuar mangësitë eventuale në afat të caktuar;
 - 1.3. Të kontrollojë pajisjet e parkingjeve publike në harmoni me aktet e Administratës Komunale dhe të urdhërojë menaxherin për të mënjanuar mangësitë eventuale, në afat të caktuar;
 - 1.4. Të urdhërojë ndërrimin e regjimit të trafikut gjegjësisht parkimit në parkingjet publike me qëllim të rritjes së shkallës së sigurisë në trafik, duke u bazuar në rekomandimet profesionale.

Neni 27

Autorizimet tjera të inspektorit

1. Inspektori është i autorizuar të urdhërojë shfrytëzuesit e parkingut largimin e menjëhershëm të mjetit motorik i cili është parkuar në kundërshtim me këtë rregullore, duke iu kërcënuar për largim të dhunshëm të mjetit motorik.
2. Në rastin nga paragrafi 1 i këtij neni, nëse shfrytëzuesi nuk ndodhet në vendngjarje ose kundërshton largimin e automjetit, inspektori do të fotografojë automjetin dhe do të merr vendim me të cilin i urdhërohet largimi i automjetit në afat të caktuar, me kërcënim të largimit të dhunshëm.
3. Vendimi nga paragrafi 2 i këtij neni vendoset në automjet, duke shënuar ditën dhe orën e vendosjes dhe me këtë konsiderohet se vendimi i është dorëzuar në mënyrë të rregullt.
4. Inspektori merr vendim për lejimin e ekzekutimit, duke përdorur automjetin special (merimange), në rast se shfrytëzuesi nuk vepron në harmoni me urdhrin sipas paragrafit 1 të këtij neni, gjegjësisht sipas vendimit nga paragrafi 2 i këtij neni.
5. Inspektori është i autorizuar të kontrollojë nëse parkingjet publike përdoren në harmoni me destinimin e definuar me këtë rregullore, dhe të urdhërojë mënjanimin e mangësive në afat të caktuar.
6. Inspektori është i autorizuar të shqiptojë gjobë mandatore, të bëjë kërkesë për kallëzim kundërvajtje, në rast të mos veprimit sipas vendimit ekzekutiv, si dhe të ndër marr masa tjera, të duhura për shfrytëzimin e parkingjeve publike, në harmoni me këtë rregullore dhe akteve tjera të nxjerra në bazë të kësaj rregulloreje.

Neni 28

Dispozitat ndëshkuese - gjobat

1. Me gjobë prej pesëqind (500) € deri në një mijë (1 000) € do të ndëshkohet menaxheri për këto kundërvajtje:
 - 1.1. nëse nuk vepron në përputhje me nenin 10 të kësaj rregulloreje;
 - 1.2. nëse nuk vepron në përputhje me nenin 11 të kësaj rregulloreje;
 - 1.3. nëse nuk e pajise parkingun publik në përputhje me nenin 14 të kësaj rregulloreje.
2. Me gjobë prej 500 € deri 1000 € do të ndëshkohet menaxheri apo subjekti tjetër juridik nëse:
 - 1.1. përdor parkingjet publike në kundërshtim me nenin 19 paragrafi 2 të kësaj rregulloreje;

1.2. vepron në kundërshtim me nenin 23 të kësaj rregulloreje.

3. Me gjobë prej pesëdhjetë (50) € deri në dyqind (200) €, do të ndëshkohet personi fizik, i cili vepron në kundërshtim me nenin 23 të kësaj rregulloreje.

Neni 29

Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

Për zbatimin e kësaj rregulloreje obligohen: kryetari i komunës, Drejtoria për Shërbime Publike, Drejtoria për Inspektime dhe drejtorit tjera kompetente komunale.

Neni 30

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Shpëtim Zhegrova
Kryesues i Kuvendit

